

Vendim nr. 265 datë 22.10.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Genti Ibrahim, i,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 22.10.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 13 (M) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket

KËRKUES: **MUNIR KALOSHI**, përfaqësuar me prokurë të posaçme nga avokat Sokol Gjini.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-3921, datë 09.10.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 18, 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 1 i Protokollit 12 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Munir Kaloshi është trashëgimtar testamentar i Flora Kaloshit, e cila ka qenë një nga trashëgimtarët ligjore të babait Mustafa (Taf) Kaziu, si dhe vëllait të saj Hajredin Kaziu (trashëgimlënësit). Flora Kaloshi së bashku me trashëgimtarët e tjerë, sipas radhës, i është drejtuar me kërkesë Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Bashkisë Tiranë (KKKP) për njohjen e pronave të ish-pronarëve/trashëgimlënësve Mustafa (Taf) Kaziu, si dhe vëllait të saj Hajredin Kaziu.

2. Me vendimin nr. 710, datë 13.09.1994 të KKKP-së, Bashkia Tiranë trashëgimtarëve të Taf Kaziut u është njohur pronësia për një shtëpi trekatëshe, të ndërtuar mbi një truall me sipërfaqe 165 m² të ndodhur në Tiranë. Ndërsa me vendimin nr. 704, datë 13.09.1994 të KKKP-së, Bashkia Tiranë, trashëgimtarëve të Hajredin Kaziut u është njohur pronësia për një sipërfaqe 231 m² të ndodhur në Tiranë. Pronat ndodhen pranë njëra-tjetrës, përkatësisht prona e trashëgimtarëve të Taf Kaziu ndodhet në veri të pronës së trashëgimtarëve të Hajredin Kaziu. Gjithashtu, me pronën me sipërfaqen 231 m² ka qenë kufitar edhe shtetasi Sefer Muharrem Metani, pronar i një trualli me sipërfaqe 85.5 m². Sefer Muharrem Metani me prokurë të posaçme ka caktuar përfaqësues djalin e tij, Muharrem Metani, të cilit i ka dhënë tagra për të shitur truallin. Me kontratën e datës 14.09.1999 Muharrem Metani ia ka shitur truallin me sipërfaqe 85.5 m² shtetasit Kol Gjoni. Në këtë truall, shtetasi Kol Gjoni ka ndërtuar një banesë, sipas lejes së ndërtimit të dhënë me vendimin nr. 301, datë 28.10.1999 nga Këshilli Kombëtar i Territorit Tiranë

3. Në këto rrethana, Flora Kaloshi dhe trashëgimtarët e tjerë i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padi me objekt lirim të truallit, konstatimin e pavlefshmërisë së kontratës së shitjes të lidhur mes Muharrem Metanit (shitës) dhe Kol Gjoni (blerës), konstatimin e pavlefshmërisë së regjistrimit hipotekar të bërë në favor të Kol Gjoni, pavlefshmërinë e lejes së ndërtimit të dhënë në favor të tij, si dhe saktësimin e të dhënave tekstuale të sipërfaqes së truallit.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 230, datë 27.01.2004, ka vendosur rrëzimin e padisë si të pabazuar në prova dhe ligj. Pas ankimit të paditësve, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1147, datë 21.10.2004, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 230, datë 27.01.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim po asaj gjykate, me tjetër trup gjykues. Pas rekursit të palës së paditur, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 22, datë 12.01.2006, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1147, datë 21.10.2004 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

5. Në rishqyrtim, pas dërgimit të çështjes nga Gjykata e Lartë sipas vendimit të mësipërm, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1355, datë 09.11.2007, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 230, datë 27.01.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke vendosur pranimin e kërkesëpadisë; konstatimin e pavlefshmërisë së kontratës së shitblerjes të datës 12.09.1999 për blerjen e truallit me sipërfaqe 85.5 m² nga Kol Gjoni; konstatimin e pavlefshmërisë së regjistrimit hipotekar nr. 230, datë 15.09.1999 në favor të Kol Gjonit/i paditur; pavlefshmërinë e lejes së ndërtimit të objektit 2-katësh të dhënë në favor të Kol Gjonit, duke urdhëruar fshirjen e pronës nga regjistrat e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë; saktësimin e vendimeve nr. 704 dhe nr. 710, datë 13.09.1994 të KKKP-së, Bashkia Tiranë në favor të trashëgimtarë të ish-pronarëve Mustafa (Taf) e Hajredin Kaziu, duke njësuar të dhënat tekstuale të sipërfaqes së truallit të kthyer me sipërfaqen e përfshirë në planvendosjen (anë grafike) që ka shoqëruar këto vendime, pasi sipërfaqja e përgjithshme e truallit të kthyer është 407 m²; detyrimin e Kol Gjonit për të liruar dhe dorëzuar truallin që kanë zënë trashëgimtarët e Mustafa (Taf) e Hajredin Kaziut/paditës në gjykim.

6. Pas rekursit të palës së paditur, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2013-2621 (513) datë 25.09.2013, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1355, datë 09.11.2007 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, duke lënë detyra për gjykatën e apelit në drejtim të: verifikimit të legjitimitetit të palëve; afateve për ngritjen e kërtimeve dhe juridiksionit gjyqësor për kërkime të caktuara; riekspertimin topografik mbi bazën e analizës së saktë të provave dhe azhurnimit në terren të pronës për përcaktimin kategorik të vendndodhjes së pronave të palëve ndërgjyqëse; faktit nëse ato mbivendosen me njëra-tjetrën për të arritur në një vendim të drejtë e të bazuar në ligj.

7. Pas dërgimit të çështjes për rishqyrtim, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 7, datë 15.04.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 230, datë 27.01.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

8. Paditësit në muajin maj të vitit 2016 kanë ushtruar rekurs ndaj vendimit të gjykatës së apelit. Në datën 26.07.2018 Flora Kaloshi/paditëse ka ndërruar jetë. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-3921, datë 09.10.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

9. Kërkuesi, në cilësinë e trashëgimtarit të Flora Kaloshit, në datën 03.06.2025 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili,

pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 18.06.2025.

10. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuessit

11. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se gjatë procesit gjyqësor është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

11.1. *Parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë është treguar e njëanshme, sepse nuk ka marrë në shqyrtim dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve dhe kërtimeve të palës paditëse. Gjykata e Lartë ka tejkaluar dhe nuk ka vepruar në përputhje me detyrimet e saj ligjore.

11.2. *Parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme*, pasi Gjykata e Lartë duhej të verifikonte ligjshmërinë e nxjerrjes së akteve, sikur veproi Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1355, datë 09.11.2007, me të cilin aktet administrative janë deklaruar të pavlefshme, duke rregulluar edhe pasojat që kishin sjellë ato. Cenimi i parimit të sigurisë juridike lidhet me faktin se pala e paditur e ka fituar pronësinë nëpërmjet akteve të dala në kundërshtim me ligjin dhe Gjykata e Lartë duhet të verifikonte procedurën e nxjerrjes së tyre.

11.3. *Parimit të barazisë përpara ligjit*, të parashikuar në nenin 18 të Kushtetutës, sipas të cilit të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.

11.4. *Së drejtës së pronësisë*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka zhvilluar një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, duke moszbatuar e duke dalë tej kufijve të ligjit, për rrjedhojë ka mohuar në mënyrë arbitrare të drejtën e pronës.

11.5. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë nuk i plotëson kërkesat dhe standardet e vendosura nga Gjykata për arsyetimin e vendimit gjyqësor. Gjykata e Lartë nuk ka dhënë argumente dhe nuk e ka arsyetuar vendimin e saj.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkesës

12. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

13. Kolegji vëren se kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, ndaj mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitimit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkesin. Në këtë drejtim, mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së kriterëve, me pasojë moskalimin e saj në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit kriter që të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

14. Për sa më lart, Kolegji çmon të ndalet në analizën e legjitimitimit *ratione materiae*, duke evidentuar se kërkesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë i ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të gjyimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimit të sigurtë juridike dhe pritshmërive të ligjshme, parimit të barazisë përpara ligjit, së drejtës së pronësisë dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

15. Për pretendimin për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit, Kolegji vëren se kërkesi nuk ka parashtruar asnjë argument konkret, por vetëm e ka cituar këtë parim, për rrjedhojë ai nuk mund të merret në shqyrtim.

16. Për sa u takon pretendimeve të tjera për cenimin e parimit të gjyimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimit të sigurtë juridike e pritshmërive të ligjshme, së drejtës së pronësisë dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, Kolegji vlerëson se kërkesi në

thelb ka parashtruar të njëjtat argumente, duke pretenduar se Gjykata e Lartë nuk u ka thënë përgjigje pretendimeve për cenimin e së drejtës së pronësisë dhe se vendimi i asaj gjykate nuk ka respektuar standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, duke sjellë si pasojë edhe cenimin e së drejtës së aksesit. Për këtë arsye, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuarit do të analizohen në vijim në drejtim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

B. Për pretendimin për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

17. Kërkuari ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk ka marrë në shqyrtim dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve për cenimin e së drejtës së pronësisë dhe se duhet të verifikonte ligjshmërinë e nxjerrjes së akteve, sikur ka vepruar Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 1355, datë 09.11.2007, me të cilin aktet administrative janë deklaruar të pavlefshme, duke rregulluar edhe pasojat që ato kishin sjellë. Vendimi i Gjykatës së Lartë nuk i plotëson kërkesat dhe standardet e vendosura nga Gjykata për arsytimin e vendimit gjyqësor, si dhe nuk ka dhënë argumente e nuk ka arsyetuar vendimin e saj.

18. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 6, datë 22.02.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në lidhje me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për vendim gjyqësor të arsyetuar. Arsytimi i vendimeve është element thelbësor i drejtësisë së vendimeve. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Gjykata ka pohuar se standardi i arsytimit është i lidhur edhe me respektimin e të drejtave të tjera kushtetuese, siç është edhe e drejta e aksesit në gjykim. Megjithatë, zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e

kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 45, datë 03.07.2017; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Për sa i takon vendimit të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit, në jurisprudencë konstante të Gjykatës është pranuar se ato mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të Gjykatës së Lartë gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 67, datë 03.10.2024; nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata, po ashtu, është shprehur se në vlerësimin e shkaqeve ligjore të rekursit dhe bazueshmërisë së tyre duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore, nëse kolegji i Gjykatës së Lartë krijon bindjen se ato janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, vendos mospranimin e tij (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 9, datë 26.03.2018; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Po kështu, Gjykata në vijimësi është shprehur se zbatimi i ligjit është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm. Kjo do të thotë se Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që e bën të padrejtë gjykimin (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Referuar standardeve të mësipërme kushtetuese, Kolegji do të analizojë nëse vendimi i Gjykatës së Lartë u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuarit dhe nëse arsyetimi i atij vendimi është mjaftueshëm i qartë në përmbajtje, si dhe nëse interpretimi i ligjit nga gjykatat ka qenë ose jo arbitrar në këndvështrimin kushtetues.

23. Në rastin konkret, Kolegji vëren se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është vënë në lëvizje me kërkesëpadi nëpërmjet së cilës është kërkuar lrimi i truallit, konstatimi i pavlefshmërisë së kontratës së shitjes të lidhur mes Muharrem Metanit dhe Kol Gjonit, konstatimi i pavlefshmërisë së regjistrimit hipotekar të bërë në favor të Kol Gjonit, pavlefshmëria e lejes së ndërtimit të dhënë në favor të tij dhe saktësimi i të dhënave tekstuale

të sipërfaqes së truallit të kthyer. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në prova dhe ligj, duke arsyetuar në mënyrë të përmbledhur se bazuar në dokumentet e administruara gjatë gjykimit (vendime të KKKP-së, planvendosje, harta dhe në aktet e ekspertimit) nuk u krijua bindja që pronat kanë mbivendosje mes tyre.

24. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1355, datë 09.11.2007, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pranimin e kërkesëpadisë, duke e konstatuar të pavlefshme kontratën e shitblerjes dhe veprimet e kryera për regjistrimin e pronës, si dhe detyrimin e të paditurit Kol Gjoni për të liruar dhe dorëzuar truallin. Në vendim Gjykata e Apelit Tiranë ka arsyetuar se pas përsëritjes së akteve të ekspertimit dhe këqyrjes së regjistrave të pronës ka rezultuar se regjistrimi i pronës së Kol Gjonit është bërë në kundërshtim me ligjin dhe se leja e ndërtimit në emër të tij është dhënë në kundërshtim me ligjin për urbanistikën.

25. Pas rekursit të palës së paditur, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2013-2621 (513), datë 25.09.2013, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1355, datë 09.11.2007 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues. Gjykata e Lartë e ka udhëzuar Gjykatën e Apelit Tiranë që në rishqyrtimin e çështjes të verifikojë legjitimitetin e palëve, afatet për ngritjen e kërtimeve dhe juridiksionin gjyqësor për kërkimet e caktuara, si dhe të kryejë riekspertimin topografik dhe azhurnimin në terren të pronës, me qëllim përcaktimin kategorik të vendndodhjes së pronave të palëve ndërgjyqëse dhe të faktit nëse ato mbivendosen me njëra-tjetrën, për të arritur në një vendim të drejtë e të bazuar në ligj.

26. Në rishqyrtim, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 7, datë 15.04.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ajo gjykatë ka vendosur përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, duke marrë prova/akte shkresore të paraqitura nga pala paditëse Kaziu, si dhe ka përsëritur ekspertimin topografik (*shih faqen 20 të vendimit të gjykatës së apelit*). Gjykata e apelit ka arsyetuar se në lidhje me padinë e rivendikimit, paditësit Kaziu në atë gjykim (njëri prej trashëgimtarëve të tyre edhe kërkuesi Munir Kaziu) nuk legjitimohen ta kërkojnë pronën, pasi nuk kanë provuar pronësinë e tyre. Sipas gjykatës së apelit, bazuar në vendimin unifikues nr. 24, datë 13.03.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ligji për kthimin dhe kompensimin e pronave nuk përbën mënyrë të re të fitimit të pronësisë. Në vijim, Gjykata e Apelit në arsyetimin e vendimit ka mbajtur parasysh edhe nenin 175, paragrafët e tretë dhe të katërt të Kodit Civil (KC), lidhur me ndërtimet e kryera në mirëbesim në truallin e dikujt tjetër (*shih faqen 24 të vendimit të gjykatës së apelit*), duke

arsyetuar se pala e paditur në atë gjykim, Kol Gjoni, ndërsa ka blerë kundrejt shpërblimit truallin objekt konflikti, si dhe është pajisur rregullisht me leje ndërtimi, ka realizuar ndërtimin e tij mbi këtë truall duke qenë në kushtet e mirëbesimit, pra në kushtet kur nuk e ka ditur që po ndëronte në tokën e tjetrit. Gjithashtu, në kushtet kur e gjithë veprimtaria e ndërtimit dhe objekti i ndërtuar kanë qenë të dukshëm për këdo të pranishëm, përfshirë edhe paditësit, të cilët nuk e kanë mohuar dijeninë për këtë ndërtim, atëherë mbetet të pranohet mosveprimi i tyre për të mos e penguar ndërtimin për më shumë se dy vjet. Ndërsa në lidhje me kërkimin e dytë, për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitjes, gjykata e apelit ka arsyetuar se për sa kohë paditësit nuk legjitimohen për kërkimin kryesor, ata nuk kanë interes të ligjshëm për të goditur veprimet juridike për kalimin e pronësisë, si dhe aktet administrative për dhënien e së drejtës për të ndërtuar në atë truall (*shih faqen 25 të vendimit të gjykatës së apelit*).

27. Paditësit, mes tyre edhe Flora Kaloshi, në muajin maj të vitit 2016 kanë ushtruar rekurs ndaj vendimit të gjykatës së apelit, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur se vendimet e gjykatave më të ulëta ishin rrjedhojë e vlerësimit të njëanshëm të provave dhe në zbatim të gabuar të dispozitave të KC-së dhe ligjit për urbanistikën. Ndërkohë, në datën 26.07.2018 Flora Kaloshi ka ndërruar jetë dhe kërkuesi është trashëgimtar testamentar i saj. Për rekursin e ushtruar nga paditësit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-3921, datë 09.10.2024, ka vendosur mospranimin e tij, pasi nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se gjykatat më të ulëta kanë respektuar normat procedurale, si dhe ato materiale për zgjidhjen e çështjes. Palët kanë realizuar të drejtën e tyre të mbrojtjes, kanë paraqitur prova, duke pasur mundësi debati dhe kanë shprehur qëndrimin për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Gjykata e Lartë ka theksuar rolin dhe juridiksionin e saj se nëpërmjet gjykimit në atë gjykatë nuk mund të pretendohet rihapje e shqyrtimit gjyqësor të provave.

28. Në këndvështrim të përmbajtjes së pretendimeve të kërkuesit dhe në analizë të vendimeve gjyqësore, Kolegji vëren se trashëgimlënësja e kërkuesit, si palë paditëse gjatë gjykimit të çështjes në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, pasi ka ushtruar lirisht të drejtën e padisë dhe atë të ankimit në gjykatat më të larta, në përfundim të gjykimit ka marrë përgjigje të arsyetuar për pretendimet e parashtruara përpara gjykatave të zakonshme, konkretisht për kërkimet për padinë e rivendikimit, për të cilën nuk është legjitimuar, duke mos pasur të drejtë ose interes të ligjshëm për të kundërshtuar edhe veprimet për kalimin e pronësisë tek të tjerët, veprimet administrative për regjistrimin në regjistrat hipotekarë të akteve të kalimit të pronësisë, si dhe aktet administrative për dhënien e lejes së ndërtimit. Ndërsa, Kolegji Civil i

Gjykatës së Lartë, vendimi i të cilit është objekt kundërshtimi në Gjykatë, ka vendosur mospranimin e rekursit, duke pranuar në thelb arsyetimin e Gjykatës së Apelit Tiranë.

29. Nën këtë optikë, Kolegji vlerëson se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë përmbushur detyrimin për arsyetimin e vendimit të tyre, ndërkohë që interpretimi nga ato i ligjit, i shprehur përmes arsyetimit, për sa i përket identifikimit të ligjit të zbatueshëm, nuk rezulton i paarsyeshëm ose arbitrar në këndvështrimin kushtetues, në kuptimin që të bjerë ndesh me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës. Ato gjykata kanë marrë në shqyrtim, analizuar dhe vlerësuar në mënyrë të argumentuar pretendimet gjatë procesit gjyqësor dhe ato të paraqitura në rekurs, në respektim të së drejtës së aksesit. Duke pasur parasysh natyrën e vendimit të kundërshtuar të Gjykatës së Lartë, përmes të cilit, në kuadër të verifikimit të kriterëve të pranueshmërisë së rekursit, është vendosur mospranimi i tij, si dhe faktin se në të janë listuar shkaqet e parashtruara në rekurs dhe pavarësisht arsyetimit të kufizuar në lidhje me to, pra se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së, Kolegji vlerëson se, në kundërshtim nga sa kërkuesi pretendon, arsyetimi i këtij vendimi nuk rezulton në cenim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, sipas jurisprudencës kushtetuese. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

30. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.